

Në datën **28.08.1998**, që të gjithë u nisën të farefisi në fshatin Osek Hilë/Osek Hilja. Me ta u nis edhe i afërmi i tyre Muharremi, sepse shkonin përmes **Skivjanit/Skivjane**, ku ai kishte shumë miq. Muharremi u ndal në Skivjan, ndërkaq Fana me të bijat e vazhduan rrugën për në Osek Hilë/Osek Hilja. Ishte kjo hera e fundit kur i shihnin të gjallë. Pas lufte, trupi i Fanës u zhvarros nga varrezat në fshatin Piskotë/Piskot [Gjakovë/Đakovica]. Identifikimi i mbe-tjeve të saj mortore u bë në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac më 10.08.2005. Familjarët e kanë varrosur Fanën po atë ditë në varrezat fshatit Babaloq/Babaloć. Fati i Shqipës dhe i Xufes ende nuk është ndriçuar. Ato janë të regjistruara si persona të zhdukur nga KNKK-ja dhe lëndët e tyre janë të sistemuara me numrat BLG-803245-02 dhe BLG-803245-03.

**Burimet:** deklarata M.Ç, FDH-19262; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Mehmet (Hazir) Rrustemaj

(6.04.1953, shqiptar nga Dujaka/Dujak, komuna e Gjakovës/Đakovica, tregtar, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Që nga fillimi i vitit 1998, Mehmeti u angazhua në mbrojtjen e fshatit të vet dhe furnizimin e pjesëtarëve të UÇK-së me armatime. E veshi uniformën e UÇK-së më 20.04.1998. Ka qenë pjesëtar i njësitit të UÇK-së në Dujakë/Dujak. Në datën 30.08.1998, Mehmeti ka dal nga shtëpia nga ora 11:00. I tha bashkëshortes Minires që do të kthehej diku me mbrëmja. E kishte marr me vete *kallashnikovin* e vet. Nga ajo ditë, familjarët nuk e kanë parë më kurrë. Një javë më pas, Minirja pati dëgjuar nga Zef Lulina se Mehmeti ka pësuar më **30.08.1998**. Pak më vonë, familjarët kanë mësuar se ditën kritike Mehmeti kishte rënë në pritën e forcave serbe, te vendi i quajtur *Sukat e Biteshit/Biteške çuke* në fshatin **Bitesh i Ulët /Donji Biteš**. Pas përfundimit të luftës, Minirja ka dëgjuar se kufoma e Mehmetit ishte varrosur në varrezat e fshatit **Osek Hilë/Osek Hilja**. Në datën 14.04.2005, mbetjet e tij morto-

re janë rivarrosur në varrezat e Dujakës/Dujak.

**Burimet:** deklarata M.R, FDH-29787; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297.

## Haxhi (Nekë) Alija

(13.07.1933, shqiptar nga Kodralia/Kodralija, komuna e Gjakovës/Đakovica, gjashtë fëmijë)

## Halil (Haxhi) Alija

(12.08.1975, shqiptar nga Kodralia/Kodralija, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Haxhiu jetonte me bashkëshorten Elmijen, djemtë Halilin dhe Avniun, si dhe familjen e këtij të dytit. Halili e kishte mbaruar shkollën e mesme. Merrej me bujqësi. U inkadrua në njësitin e UÇK-së në fshatin e vet më 20.05.1998. Herët në mëngjes, më 3.09.1998, menjëherë pas lajmit se forcat serbe po i afroreshin fshatit, familja e Haxhiut me banorë të fshatit i braktisën shtëpitë dhe u mblodhën në një fushë. Në anën tjetër, Halili u rreshtua ne radhët e mbrojtësve të fshatit. Pasi hyrën në fshat, policët dhe ushtarët serb i rrethuan fshatarët në fushë. Hyrën në mesin e tyre, i ndanë disa prej burrave shqiptarë dhe nisën t'i rrihnin në sytë të tjerëve. Babai i Halilit, Haxhiu, e kundërshtoi me zë një sjellje të tillë të forcave serbe. Policët dhe ushtarët e ndan nga radha dhe filluan ta rrihnin edhe vet atë. Pas afro dy orësh, forcat serbe u lejuan fshatarëve që të largoheshin. Civilët shkuan dhe u strehuan në fshatin Bec. Por, po atë ditë, Haxhiu ndërroi jetë nga dëmtimet e rënda si pasojë të keqtrajtimeve të rëndë fizik. E varrosën në varrezat e fshatit Bec. Tri ditë më vonë, vëllai i Halilit, Imeri, ka dëgjuar nga axha i tyre se Halilin e kishin vrrarë më **3.09.1998**, kur forcat serbe kishin depërtuar në **Kodrali/Kodralija**. Axha e kishte gjetur trupin e Halilit në vendin e quajtur *Te Vera* dhe e ka varrosur në të njëjtën ditë në varrezat e Kodralisë/Kodralija, ku ai prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata A.A, FDH-32440; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Ali (Hazir) Kalimashi

(12.04.1961, shqiptar nga Kodralia/Kodralija,